



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 29
Prishtinë, 27 janar 2009, ora 13: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina..

Munguan: Sllobodan Petroviq dhe Teuta Hadri.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Përgatitjet e organizimit të dëgjimit publik për monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi;**
- 4. Shqyrtimi i shkresës së pronarit të fabrikës për prodhimin e produkteve farmaceutike “New-Co Farmakos”- Prizren;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Mimoza Ahmetaj – Tha në diskutimin e saj se lidhur me listën e të ftuarve në dëgjim publik, ka thënë: “... nuk ka njohuri se kush është Sindikata për Punë Ndërkombëtare e Kosovës, si dhe në listën e të ftuarve për dëgjim publik, figuron Shoqata e Anesteziologëve dhe Asociacioni Kosovar i Anesteziologëve, propozoi të ftohet vetëm njëra nga këto të dyja ...”

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar me vërejtjen e deputetes Mimoza Ahmetaj.

3. Përgatitjet e organizimit të dëgjimit publik për monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi

Sadik Idriz – Tha se Komisioni është pajtuar që dëgjimi publik të mbahet me 4 shkurt 2009, në orën 11:00. I kemi përgatitur ftesat dhe listën e të ftuarve. Nëse e konsideroni se edhe dikush duhet të ftohet, atëherë mund ta bëjmë këtë. Hap diskutimin.

Mimoza Ahmetaj – Pyeti se me çfarë kriteri është zgjedhur klinika “Gjermane e Syrit”, për t’u ftuar në dëgjim publik, duke e ditur që kjo klinikë është e palicencuar. Nëse Komisioni ka vendosur ta ftojë në dëgjim publik përfaqësuesin e kësaj klinike, propozoj të ftohen edhe përfaqësues të dy klinikave të tjera, që janë të licencuara, si p.sh “ARS MEDIKA”. Nga institucionet private laboratorike propozoj të ftohet “BIOTICUS”.

Gjynaze Sylja – Lidhur me rrjedhën e dëgjimit publik, kërkoi nga kryesuesi, që deputetëve të mos u kufizohet e drejta për të bërë pyetje. Është mirë të kufizohet koha e diskutimit dhe për të të njoftohen me kohë të ftuarit - përmes ftesës.

Sadik Idriz – Tha se është e drejtë e deputetëve të bëjnë pyetje, por duhet t’u shmangemi diskutimeve të gjata. Sa i përket kohëzgjatjes së diskutimit të të ftuarve, e kemi kufizuar në pesë minuta. Këtë e kemi precizuar edhe në ftesë.

Nurishahe Hulaj – Tha se është punuar mjaft për organizimin e dëgjimit publik. Konsideroj se koha duhet të jetë në dispozicion të të ftuarve, në mënyrë që të marrim sa më shumë njoftime.

3. Shqyrtimi i ankesës së pronarit të fabrikës për prodhimin e produkteve farmaceutike “New-Co Farmakos”- Prizren

Sadik Idriz - Tha se Komisioni nuk ka të drejtë të merret drejtpërdrejtë me këtë çështje, por mund të japë ndonjë sugjerim. Kjo kompani i ka të punësuar rreth 50 punëtorë dhe gjatë gjithë kohës sa ka punuar asnjëherë nuk ka pasur ndonjë skandal. Ankesa e pronarit i është drejtuar Bordit të Ankesave, kurse Komisioni vetëm është njoftuar për këtë çështje.

Rita Hajzeraj – Tha, para se Komisioni të vendosë për ndonjë sugjerim, duhet t’i dëgjojë përfaqësuesit e palëve për këtë çështje, në mënyrë që të dimë se cila është e vërteta. Ankesa është bazuar në moszbatimin e ligjit nga ana e institucioneve, prandaj Komisioni e ka për detyrë ta monitorojë zbatimin e këtij ligji.

Gjynaze Sylja – Tha se ka propozuar edhe në mbledhjen e kaluar që të dëgjohen përfaqësuesit e të dyja palëve. Është rregull që ankesat e qytetarëve të adresohen në Komisionin për Peticione. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale mund vetëm t’i japë sugjerim Komisionit për

Peticione. Për këtë duhet të njoftohet edhe pronari i fabrikës “ New Co-Farmakos”. Çështja më e ndjeshme në gjithë këtë është fakti se kjo fabrikë i ka të punësuar rreth 50 punëtorë.

Mimoza Ahemtaj – Tha se kjo kompani i ka të punësuar 50 punëtorë, por çka ndodh nëse cilësia e barnave ose saktësia e prodhimit të tyre brenda është e dyshimtë?

Flora Brovina – Tha se ky komision nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Megjithatë kompetencë e këtij komisioni është politikëbërja në shëndetësi. Propozoi që Komisioni t’i vizitojë “Farmakosin” dhe “Kondirollin”, pastaj, pasi të njoftohet për situatën, mund ta propozojë ndonjë zgjidhje.

Bujar Bukoshi – Tha se këtu janë dy - tri momente: është Inspektorati Shëndetësor për Produkte Medicinale, që nuk qenka mbështetur në ligj. E dyta nuk ka ligj ose akt nënligjor dhe e treta, pronari po e konteston profesionalizmin e Inspektoratit. Në radhë të parë duhet të marrim informata se si ka vendosur Bordi për Ankesa.

Qamile Morina – Tha se vendimi i kryeshefit ekzekutiv të AKPM-së është bazuar jo vetëm në ligj, por edhe në udhërrëfyes të OBSH-së. Duhet të dimë se cilët janë ata udhërrëfyes dhe sa lejon ligji të bazohemi në udhërrëfyes. Këtu është potencuar edhe koha se sa i është dashur për ta marrë një përgjigje. Pra, nëse ligji është shkelur nga institucioni, atëherë nuk kanë të drejtë të kërkojnë nga dikush tjetër që të respektohet me përpikëri ai ligj. Rilicencimi është refuzuar për shkak të mosplotësimit të kushteve të PMP-së (cilësia e produkteve). E dimë se nuk ka kuadër të certifikuar për PMP-në, por pse nuk mendohet për angazhimin e ekspertëve për ta bërë këtë?

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Në një nga mbledhjet e radhës Komisioni do të ftojë përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesin e fabrikës “New-Co Farmakos”, përfaqësues të Inspektoratit për Produkte të Pajisjeve Medicinale dhe përfaqësues të AKPM-së.

4. Të ndryshme

a) Plani i punës së Komisionit

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit për procedimin e strategjisë legjislativë të Qeverisë në Kuvendin e Kosovës. Komisioni në mbledhjen e radhës do ta shqyrtojë planin e punës. Tha se Komisioni do të jetë mjaft i ngarkuar me ligje. Në mbledhjen e radhës do të diskutojmë, a mund ta parashohim në plan të punës monitorimin e ndonjë ligji për këtë vit apo jo?

Flora Brovina – Tha se sipas strategjisë legjislativë për këtë vit, tri ligje të Komisionit janë bazike: Ligji i punës, Ligji për sigurime shëndetësore dhe Ligji për pensione dhe për invaliditet. Propozoi që në plan të punës t’i parashohim edhe kontaktet me Maqedoninë dhe Slloveninë, për ta parë përvojën e tyre lidhur me këto ligje.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz